FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 52

Tiranë – E enjte, 1 prill 2021

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 28/2021, datë 8.3.2021	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 124/2015 "Për efiçencën e energjisë", të ndryshuar.....	5361
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 13, datë 31.3.2021	Për një ndryshim në ligjin nr. 8668, datë 23.10.2000, "Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit", të ndryshuar.....	5370
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 183, datë 26.3.2021	Për një ndryshim në urdhrin nr. 633, datë 17.11.2020, "Për ndalimin e grumbullimeve në vende të mbyllura apo të hapura".....	5370
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 144, datë 30.3.2021	Për ndalimin e peshkimit në liqenin e Shkodrës.....	5370
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 10, datë 4.3.2021	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 80-2016-6107, datë 19.12.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe nr. 3748, datë 23.10.2018, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.....	5371

LIGJ
Nr. 28/2021

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 124/2015 "PËR EFIÇENCËN E ENERGJISË", TË NDRYSHUAR[1]

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI

Në ligjin nr. 124/2015 "Për efiçencën e energjisë", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 4 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 6 shfuqizohet.

2. Pas pikës 30 shtohen pikat 31 e 32 me këtë përmbajtje:

"31. "Agregatori" është një ofrues i shërbimit sipas kërkesës që kombinon ngarkesa të konsumatorëve të shumëfishtë me kohëzgjatje të shkurtër për t'i shitur ose vendosur në ankand në tregjet e organizuara të energjisë.

32."Autoritetet publike" janë autoritetet kontraktuese, siç përkufizohen në legjislacionin e zbatueshëm shqiptar për prokurimet publike.".

3. Pika 11 ndryshohet si më poshtë:

"11. "Konsumator i madh i energjisë" është një konsumator fundor, i cili ka konsum vjetor të energjisë më të madh se 1 milion kwh energji elektrike në vit.".

4. Pas pikës 22 shtohet pika 22/1 me këtë përmbajtje:

"22/1. "Organet e qeverisjes qendrore" janë të gjitha organet dhe institucionet e administratës shtetërore, sipas përcaktimit të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", përfshirë institucionin e Presidencës, Kuvendin dhe institucionet e pavarura kushtetuese ose të krijuara me ligj, kompetenca e të cilave shtrihet mbi të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.".

5. Pika 27 ndryshohet si më poshtë:

"27. Rinovim i konsiderueshëm është rinovimi i një ndërtese, ku më shumë se 25 për qind e sipërfaqes së ndërtimit të ndërtesës i nënshtrohet rinovimit, që nënkupton ndërhyrjen nëpërmjet rikonstruksionit dhe/ose ristrukturimit në mbështjelljen e jashtme dhe në sistemin teknik të ndërtesës, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për performancën e energjisë në ndërtesa.".

6. Pas pikës 27 shtohet pika 27/1 me këtë përmbajtje:

"27/1. "Stoku i ndërtesave" është sipërfaqja totale e banueshme dhe e përdorshme e ndërtesave ekzistuese në territorin e Republikës së Shqipërisë, qofshin këto publike ose private, sipas përcaktimeve të nenit 4 dhe të pikës 7 të nenit 5 për të cilat zbatohet ligji nr. 116/2016 "Për performancën e energjisë së ndërtesave.".

Neni 2

Në nenin 6 pika 3 ndryshohet si më poshtë:

"3. Objektivi kombëtar i kursimit të energjisë përcaktohet në Planin Kombëtar të Veprimit për Efiçencën e Energjisë dhe në Planin e Integruar të Energjisë dhe Klimës. Një kopje e Planit Kombëtar të Veprimit për Efiçencën e Energjisë i dërgohet Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, sipas përcaktimit në pikën 1 të nenit 7 të këtij ligji.".

Neni 3

Në nenin 7, pika 2, pas shkronjës "i" shtohen shkronjat "j" dhe "k" me këtë përmbajtje:

"j) masat ndërsektoriale që zbatohen nga subjektet publike dhe private;

k)plani i veprimit afatgjatë për mobilizimin e investimeve për rinovime të stokut kombëtar të ndërtesave të banimit, atyre publike dhe të shërbimeve, qofshin këto publike dhe private;".

[1] Ky ligj është përafruar pjesërisht me:

- Direktivën 2012/27/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 25 tetor 2012, "Për efiçencën e energjisë, që ndryshon direktivat 2009/125/KE dhe 2010/30/BE dhe që shfuqizon direktivat 2004/8/KE dhe 2006/32/KE", e ndryshuar". Numri CELEX 32012L0027, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 315, datë 14.11.2012, f. 1–56.

Neni 4

1. Në nenin 8, pas pikës 5 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

"6. Agjencia përgjegjëse për Efiçencën e Energjisë publikon rregullisht në faqen e saj zyrtare të gjitha raportet e përgatitura, sipas parashikimeve të pikave 3, 4 e 5 të këtij neni. Të gjitha veprimtaritë e monitorimit e të raportimit të kryera nga kjo agjenci raportohen në Platformën e Monitorimit dhe Verifikimit (MVP), e cila është një bazë e centralizuar të dhënash, që shërben si bazë për të analizuar e vlerësuar nëse janë arritur objektivat e efiçencës së energjisë dhe për të hartuar raportin vjetor për progresin e zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Efiçencën e Energjisë dhe të Planit të Integruar të Energjisë dhe Klimës. Platforma e Monitorimit dhe Verifikimit miratohet nga Këshilli i Ministrave në përputhje me parashikimet në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore.".

Neni 5

Neni 9 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 9
Masat për efiçencën e energjisë që lidhen me blerjen nga autoritetet publike

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë, përfshin në rregullat e prokurimit publik dispozita që detyrojnë autoritetet kontraktore publike për të blerë vetëm produkte, shërbime dhe ndërtesa me performancë të lartë të efiçencës së energjisë, për sa kohë që kjo është në përputhje me efektivitetin e kostove, fizibilitetin ekonomik, qëndrueshmërinë më të gjerë, përshtatshmërinë teknike, si dhe konkurrencën e mjaftueshme, siç përcaktohet në legjislacionin përkatës për prokurimet publike.

2. Kriteret teknike të referuara në pikën 1 të këtij neni përfshijnë:

a) kriteret specifike të detyrueshme lidhur me nivelet e efiçencës së energjisë së produkteve dhe shërbimeve që përdoren nga autoritetet kontraktuese publike gjatë prokurimit publik të tyre. Këto kritere aplikohen pavarësisht faktit nëse oferta ekonomikisht më e favorshme përdoret si kriter për përcaktimin e ofertës fituese. Kriteret u referohen standardeve shqiptare, evropiane dhe ndërkombëtare, të aplikueshme për të gjitha pajisjet e produktet që blihen nga autoritetet publike në Shqipëri. Nëse për një produkt të veçantë nuk ka asnjë standard shqiptar të aplikueshëm për efiçencën e energjisë, zbatohen standardet ndërkombëtare dhe standardet përkatëse teknike në fuqi të Bashkimit Evropian për këtë produkt të veçantë;

b) një metodologji për mundësinë e aplikimit të pikëve shtesë që jepen nga autoritetet publike ndaj ofertuesve që tejkalojnë standardet minimale të efiçencës së energjisë të përcaktuara në të, në rast se qasja e ofertës ekonomikisht më të favorshme do të përdoret si kriter për përcaktimin e ofertës fituese;

c) detyrimin e autoriteteve publike që t'i japin prioritet treguesit të efiçencës së energjisë në rast se blejnë një paketë produktesh si një të vetme, në krahasim me efiçencën e energjisë së produkteve individuale brenda asaj pakete, duke blerë në këtë mënyrë paketën e produktit që përputhet me kriterin, i cili i përket klasës më të lartë të efiçencës së energjisë, pa anashkaluar gjithsesi kushtin e përmbushjes së standardeve minimale për të gjitha produktet e shërbimet individuale.".

Neni 6

Pas nenit 9 shtohen nenet 9/1, 9/2, 9/3 dhe 9/4 me këtë përmbajtje:

"Neni 9/1
Planet vendore të veprimit për efiçencë të energjisë, zbatimi dhe raportimi

1. Bashkitë përgatisin planet vendore të veprimit për efiçencë të energjisë në përputhje me Planin Kombëtar të Veprimit për Efiçencën e Energjisë dhe me Planin e Integruar të Energjisë dhe Klimës, të cilat përfshijnë politikat dhe masat për përmirësimin e efiçencës së energjisë për të gjithë sektorët që funksionojnë në nivel lokal, mbi bazën e konsumit të energjisë në nivel lokal.

2. Para miratimit nga këshilli bashkiak, projektplanet vendore të veprimit për efiçencë të energjisë konsultohen me ministrinë dhe agjencinë përgjegjëse për energjinë, si dhe me përfaqësues të grupeve të interesit dhe përfaqësues të shoqërisë civile, për vlerësimin e përputhshmërisë së tij me politikat kombëtare të efiçencës së energjisë dhe objektivat përkatës.

3. Plani vendor i veprimit për efiçencë të energjisë dhe raporti i progresit për zbatimin e planit vendor të veprimit për efiçencën e energjisë hartohen sipas formatit të miratuar nga ministri jo më vonë se 12 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

4. Bashkitë, përmes menaxherëve të emëruar të energjisë, monitorojnë rregullisht zbatimin e planit dhe arritjen e objektivave të kursimit të energjisë. Për këtë qëllim, në përputhje me parashikimet në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore, bashkitë krijojnë dhe mirëmbajnë bazën e të dhënave për konsumin e energjisë në objektet nën kontrollin e tyre dhe monitorojnë kursimet e realizuara nga zbatimi i masave në ndërtesat publike, sistemet e ujësjellësve, të ndriçimit dhe të gjitha aktivitetet me konsum të lartë të energjisë.

5. Bashkitë promovojnë në nivel vendor politikat kombëtare për efiçencën e energjisë dhe informojnë qytetarët për përfitimet nga masat për rritje të efiçencës së energjisë dhe mënyrën e realizimit të tyre.

Neni 9/2
Masat ndërsektoriale

1. Masat ndërsektoriale përcaktohen në Planin Kombëtar të Veprimit për Efiçencën e Energjisë dhe në Planin e Integruar të Energjisë dhe Klimës, sipas parashikimeve të nenit 7 të këtij ligji. Këto masa zbatohen nga subjektet publike e private, që detyrohen për zbatimin e masave për efiçencën e energjisë dhe përfshijnë ndër të tjera:

a) standarde dhe norma të miratuara nga autoritetet përgjegjëse për energjinë, që synojnë përmirësimin e efiçencës së energjisë së produkteve dhe shërbimeve, si dhe përmirësimet në ndërtesa;

b) skemat e informacionit dhe të etiketimit të energjisë;

c) sistemet inteligjente të matjes, të tilla si: pajisjet individuale të matjes, matësit me dy drejtime për vetëprodhimin e energjisë nga burime të rinovueshme, sistemet e matjes të menaxhuara nga larg dhe sistemet informuese të faturimit;

ç) trajnimin dhe edukimin që çon në aplikimin e teknologjisë dhe/ose teknikave të efiçencës së energjisë;

d) rregulloret dhe propozimet për reduktimin e taksave, të cilat kanë efektin e reduktimit të konsumit final të energjisë dhe në mënyrë të veçantë të CO_2 dhe të gazeve serrë;

dh) fushatat që fokusohen në informimin dhe promovimin e përmirësimit të efiçencës së energjisë dhe masat që duhen ndërmarrë, me qëllim përmirësimin e efiçencës së energjisë.

2. Agjencia për Efiçencën e Energjisë mundëson bashkëpunimin dhe konsultimet ndërmjet subjekteve publike dhe private gjatë miratimit të masave ndërsektoriale të përmendura në pikën 1 të këtij neni.

Neni 9/3
Rinovimi i ndërtesave

1. Për mobilizimin e investimeve për rinovime të stokut kombëtar të ndërtesave rezidenciale, të atyre publike dhe të shërbimeve, qofshin këto publike dhe private, miratohet një plan veprimi afatgjatë si pjesë përbërëse e Planit të Integruar të Energjisë dhe Klimës. Ky plan afatgjatë veprimi përfshin:

a) një vlerësim të përgjithshëm për konsumin e energjisë së stokut të ndërtesave në nivel kombëtar, bazuar në të dhënat statistikore kombëtare të sipërfaqeve të banueshme;

b) identifikimin e qasjeve me kosto efektive për rinovimet që lidhen me tipologjinë dhe funksionalitetin e ndërtesës sipas zonave klimatike;

c) politikat dhe masat lehtësuese fiskale për nxitjen e rinovimeve me kosto efektive të ndërtesave në nivel kombëtar;

ç) masat orientuese në vendimet e investimeve për ndërtesat private, industrinë e ndërtimit dhe pjesëmarrjen e institucioneve financiare;

d) një vlerësim të bazuar në studimet për minimizimin e konsumit të energjisë për stokun kombëtar të ndërtesave dhe identifikimin e kursimeve të pritshme të energjisë.

dh) përfshirjen në rinovimin e ndërtesave të stokut kombëtar të sistemeve të prodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme për vetëkonsum, sipas parashikimeve të legjislacionit për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme.

2. Plani i veprimit afatgjatë për mobilizimin e investimeve për rinovime të stokut kombëtar të ndërtesave të banimit, të atyre publike dhe të shërbimeve, qofshin këto publike dhe private, miratohet një vit pas hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe përditësohet çdo 3 (tre) vjet. Në përputhje me pikën 1 të nenit 7 të këtij ligji, ky plan i dorëzohet Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

Neni 9/4
Roli model i ndërtesave të organeve të qeverisjes qendrore

1. Duke filluar nga data 1.4.2022, sektori publik ngarkohet me zbatimin e objektivit që 3% (tre për qind) e sipërfaqes totale të stokut të ndërtesave publike me ngrohje dhe/ose ftohje, në pronësi dhe të zëna nga organet e qeverisjes qendrore, dhe 2% (dy për qind) e sipërfaqes totale të stokut të ndërtesave të tjera publike të rinovohet çdo vit për të përmbushur kërkesat minimale për performancën e energjisë.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë, miraton vendimin që përcakton sasinë në përqindje të sipërfaqes së stokut të ndërtesave publike për t'u rinovuar çdo vit kundrejt sipërfaqes totale të stokut të ndërtesave publike. Ky vendim i Këshillit të Ministrave përfshin:

a) një metodologji të veçantë që përdoret për përcaktimin e sipërfaqes së stokut dhe llogaritjen e përqindjes përkatëse të ndërtesave publike;

b) përcaktimin e sipërfaqes totale të ndërtesave publike;

c) tipologjinë e ndërtesave që kërkohet të respektojnë kërkesat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni dhe të atyre të përjashtuara nga ky detyrim;

ç) zbatueshmërinë mbi ndërtesat e shfrytëzuara nga organet e qeverisjes qendrore, vendore dhe ato të vartësisë; dhe

d) masa të tjera, të cilat zbatohen për të mundësuar rinovimin tërësor të ndërtesave të organeve të qeverisjes qendrore.

3. Vendimi i Këshillit të Ministrave, i përmendur në pikën 2 të këtij neni:

a) përcakton si objektiv ndërtesat e organeve të qeverisjes qendrore me performancën më të ulët të energjisë, të cilat kanë përparësi lidhur me masat për efiçencën e energjisë, kur kjo është e mundur si nga pikëpamja e kostos efektive, ashtu edhe teknikisht e realizueshme;

b) hartohet në përputhje me përmbajtjen e planit të veprimit afatgjatë të përshkruar në nenin 9/3 të këtij ligji.

4. Ministri nëpërmjet agjencisë përgjegjëse për efiçencën e energjisë miraton e publikon inventarin e ndërtesave me ngrohje dhe/ose ftohje të organeve të qeverisjes qendrore, me sipërfaqe të përgjithshme të shfrytëzueshme mbi 250 m^2. Inventari përfshin:

a) sipërfaqen totale të kateve në metra katrorë; dhe

b) performancën aktuale të energjisë së secilës ndërtesë ose të dhënat përkatëse që lidhen me energjinë, duke përcaktuar objektivin e performancës.

5. Me qëllim përgatitjen e inventarit, ministri, përmes agjencisë përgjegjëse për efiçencën e energjisë, u dorëzon një kërkesë për dhënien e informacionit të nevojshëm sipas pikës 3 të këtij neni subjekteve përkatëse të sektorit publik, të cilat janë të detyruara të japin informacionin e kërkuar për stokun brenda afatit të përcaktuar në kërkesë.".

Neni 7

1. Në nenin 11, pas pikës 2 shtohen pikat 3, 4, 5, 6 dhe 7 me këtë përmbajtje:

"3.Çdo person juridik që kategorizohet si konsumator i madh energjie, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve pas marrjes së rezultateve të auditimit energjetik dhe masave të identifikuara në raportin e auditimit harton një plan veprimi në përputhje me objektivat individualë për kursimin e energjisë, të parashikuara në Planin Kombëtar të Veprimit për Efiçencën e Energjisë, për zbatimin e masave të përzgjedhura prej tij, duke garantuar arritjen e një kursimi të energjisë prej të paktën 4% (katër përqindësh) të energjisë ekuivalente totale të konsumuar prej tij.

4. Plani i veprimit përmban masat e përzgjedhura për zbatim, arsyen e përzgjedhjes, koston dhe afatin e realizimit për çdo masë dhe kursimet e pritshme të energjisë para investimit. Plani regjistrohet në regjistrin kombëtar që administron agjencia përgjegjëse për efiçencën e energjisë.

5. Konsumatorët e mëdhenj të energjisë, që kanë certifikuar sistemin e tyre të menaxhimit të energjisë sipas standardit ISO 50001 nga një organ certifikues i sistemeve të menaxhimit të energjisë i akreditуar, përjashtohen nga detyrimet e këtij neni, por janë të detyruar të raportojnë brenda datës 28 shkurt të çdo viti masat e zbatuara dhe kursimet e arritura gjatë vitit paraardhës pranë agjencisë përgjegjëse për efiçencën e energjisë dhe të rishikojnë planet e tyre pas çdo raporti auditimi të detyruar.

6. Formati i planeve të veprimit të konsumatorëve të mëdhenj dhe i raportit vjetor të progresit miratohet nga ministri, me propozim të agjencisë përgjegjëse për efiçencën e energjisë.

7. Konsumatorët e mëdhenj të energjisë, që kanë certifikuar sistemin e tyre të menaxhimit të energjisë sipas standardit ISO 50001 nga një organ certifikues i sistemeve të menaxhimit të energjisë i akreditуar, duhet të dërgojnë pranë agjencisë përgjegjëse për efiçencën e energjisë certifikatën ISO 50001 brenda 6 muajsh nga publikimi i këtij ligji në Fletoren Zyrtare.".

Neni 8

Pas nenit 11 shtohet neni 11/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 11/1
Skema detyruese për efiçencën e energjisë dhe masat alternative

1. Për të siguruar përdorimin racional dhe efiçent të burimeve energjetike në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me politikën e efiçencës së energjisë të vendosur sipas këtij ligji, Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton çdo 10 vjet objektivat e kursimeve kumulative të konsumit final të energjisë në nivel kombëtar, duke filluar nga data 31.12.2021.

2. Me qëllim arritjen e objektivit kombëtar të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton një skemë detyruese për efiçencën e energjisë për operatorët e sistemeve të shpërndarjes dhe furnizuesit me pakicë të tregut të energjisë në Republikën e Shqipërisë.

3. Për qëllime të llogaritjes së objektivit kombëtar, të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, ministri, me propozim të agjencisë përgjegjëse për efiçencën e energjisë, miraton udhëzuesin që përcakton mënyrën e llogaritjes së objektivit të kursimeve kumulative të konsumit final të energjisë dhe masat që duhet të miratohen për arritjen e tij.

4. Ministri, përmes agjencisë përgjegjëse për efiçencën e energjisë, administron skemën detyruese për efiçencën e energjisë dhe monitoron zbatimin e rregullave e të dispozitave detyruese sipas udhëzimit të përcaktuar në pikën 3 të këtij neni.

5. Objektivat kumulativë të kursimit për konsumatorët fundorë, të cituar në pikën 1 të këtij neni, specifikohen në Planin e Integruar të Klimës dhe Energjisë dhe kontribuojnë në arritjen e objektivit kombëtar të efiçencës së energjisë të përcaktuar në këto plane.".

Neni 9

Neni 12 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 12
Marrëveshjet vullnetare

1. Marrëveshjet vullnetare lidhen ndërmjet konsumatorëve të mëdhenj të energjisë, bizneseve të vogla dhe të mesme industriale dhe pronarëve të ndërtesave me kompanitë e shërbimeve energjetike, sipas modelit të marrëveshjes së miratuar nga agjencia përgjegjëse për efiçencën e energjisë, për të mbështetur zbatimin e masave dhe aktiviteteve të efiçencës së energjisë, për arritjen e objektivave kombëtarë të sektorëve që mbulon efiçenca e energjisë, si dhe vetë objektivin që do të arrijë marrëveshja.

2. Marrëveshjet vullnetare të përmendura në pikën 1 të këtij neni duhet të jenë transparente, jodiskriminuese dhe të përmbajnë të paktën:

a) objektivat specifikë dhe detyrimet e çdo subjekti për zbatimin e masave të efiçencës së energjisë;

b) mënyrat e veprimet mbështetëse për arritjen e objektivave dhe zbatimin e masave të efiçencës së energjisë;

c) metodologjinë që zbatohet për vlerësimin e kursimeve dhe të objektivit specifik;

ç) të drejtën e agjencisë përgjegjëse për efiçencën e energjisë për monitorimin dhe vlerësimin e masave të efiçencës së energjisë dhe detyrimin e palës tjetër për raportim;

d) sanksionet në rast të mospërmbushjes së detyrimeve dhe procedurat e zgjidhjes së kontratës.

3. Agjencia përgjegjëse për efiçencën e energjisë ose çdo palë e tretë e pavarur dhe e emëruar nga kjo e fundit mund të marrë përsipër të kryejë një vlerësim të kostos e të përfitimit për marrëveshjen e propozuar vullnetare në mënyrë që të konfirmojë koston për efiçencën e energjisë si koston optimale në ngjashmëri me praktikat më të mira në vende të tjera.

4. Agjencia përgjegjëse për efiçencën e energjisë ndërmerr aktivitete për rritjen e shkallës së ndërgjegjësimit për përfitimet nga marrëveshjet vullnetare dhe nxit subjektet e mundshme të marrin pjesë në këto marrëveshje.".

Neni 10

Neni 13 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 13
Baza e të dhënave të energjisë

1. Agjencia përgjegjëse për efiçencën e energjisë realizon monitorimin e verifikimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Efiçencën e Energjisë, duke përfshirë planet vendore të veprimit për efiçencën e energjisë, kontratat për shërbimet energjetike dhe marrëveshjet vullnetare nëpërmjet Platformës së Monitorimit dhe Verifikimit.

2. Platforma e Monitorimit dhe Verifikimit, sipas pikës 1 të këtij neni, shërben si bazë për të vlerësuar nëse janë arritur objektivat e efiçencës së energjisë sipas këtij ligji dhe për të hartuar raportin vjetor për progresin e zbatimit të PKVEE-së.

3. Shpërndarësit e energjisë dhe shoqëritë e shitjes me pakicë të energjisë i paraqesin agjencisë përgjegjëse për efiçencën e energjisë të paktën një herë në vit informacione të përmbledhura statistikore për konsumatorët e tyre fundorë.

4. Informacioni, sipas pikës 3 të këtij neni, përmban informacion historik dhe aktual lidhur me konsumin e përdoruesve fundorë, përfshirë, kur është e mundur, profile të ngarkesës, segmentimin e konsumatorëve dhe vendndodhjen gjeografike të tyre, duke ruajtur konfidencialitetin e informacionit, që është i karakterit privat ose i ndjeshëm nga pikëpamja tregtare, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

5. Për sektorët rezidencialë, të shërbimeve, të industrisë, të transportit dhe të bujqësisë, agjencia përgjegjëse për efiçencën e energjisë, në bashkëpunim me INSTAT-in, bën sondazhe për të dhënat për konsumin e energjisë nga konsumatorët në këta sektorë.".

Neni 11

Në nenin 14, pas pikës 1 shtohen pikat 1/1 e 1/2 me këtë përmbajtje:

"1/1. Për qëllime të matjes së konsumit aktual, përfshirë këtu rastin e matjes dhe faturimit të konsumit individual në rastet e sistemeve qendrore të ngrohjes ose ftohjes në ndërtesa me shumë njësi, ambiente individuale familjare të tilla, si: apartamente e vila, të furnizuara nga rrjeti i ngrohjes ose ftohjes qendrore ose nga një burim qendror ngrohjeje i instaluar e që i shërben vetëm kësaj ndërtese, qoftë në sektorin e energjisë elektrike, ashtu edhe në atë të gazit natyror, ose nga një impiant i prodhimit të energjisë termale, instalohen sisteme matësish inteligjentë në përputhje me parashikimet e legjislacionit të zbatueshëm në fuqi për sektorin e energjisë dhe të legjislacionit të zbatueshëm në fuqi për sektorin e gazit natyror.

1/2. Të gjitha faturat për energjinë elektrike të konsumuar dhe materialet promovuese të lëshuara nga furnizuesi përmbajnë informacione të qarta në përputhje me parashikimet e legjislacionit të zbatueshëm në fuqi për sektorin e energjisë dhe parashikimet e zbatueshme të legjislacionit në fuqi për sektorin e gazit natyror. Agjencia përgjegjëse për efiçencën e energjisë bashkëpunon dhe koordinon punën me Entin Rregullator të Energjisë për transparencën e informacionin që duhet të përfshihet në faturat përkatëse, që do t'u lëshohen të gjithë konsumatorëve fundorë për konsumin aktual të tyre, sipas këtij neni.".

Neni 12

Në nenin 15 pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Agjencia përgjegjëse për efiçencën e energjisë merr masa për të nxitur e lehtësuar përdorimin efiçent të energjisë nga konsumatorët e vegjël të energjisë, përfshirë këtu konsumatorët shtëpiakë. Këto masa përfshijnë një ose disa nga elementet e listuara më poshtë:

a) një sërë instrumentesh dhe politikash për të promovuar ndryshimin e sjelljes së konsumatorit që mund të përfshijë:

i. mundësi për të përfituar financim, grante ose subvencione;

ii. dhënie informacioni;

iii. projekte shembull/model;

iv. aktivitete në vendin e punës.

b) mënyra dhe mjete për të angazhuar konsumatorët dhe grupimet e konsumatorëve gjatë instalimit fillestar të matësve inteligjentë përmes komunikimit të:

i. kostove efektive dhe ndryshimeve lehtësisht të arritshme në përdorimin e energjisë;

ii. informacionit për masat e efiçencës së energjisë.".

Neni 13

Pas nenit 15 shtohet neni 15/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 15/1
Nxitja e efiçencës së energjisë në ngrohje dhe ftohje

1. Për të nxitur efiçencën e energjisë në ngrohje dhe ftohje, përfshirë kogjenerimin me efiçencë të lartë, ministria, nëpërmjet agjencisë përgjegjëse për efiçencën e energjisë, kryen një vlerësim gjithëpërfshirës të potencialit për aplikimin e kogjenerimit me efiçencë të lartë, si dhe të ngrohjes e ftohjes efiçente. Elementet, kërkesat dhe parimet e përgjithshme të analizës së kostos dhe përfitimit të një vlerësimi të tillë rregullohen nëpërmjet udhëzimit të ministrit.

2. Vlerësimi gjithëpërfshirës i përmendur në pikën 1 të këtij neni, bazohet në analizën e kostos dhe të përfitimit që merr në konsideratë kushtet klimatike, fizibilitetin ekonomik dhe përshtatshmërinë teknike, me qëllim identifikimin e zgjidhjeve efiçente për plotësimin e nevojave për ngrohje, ftohje dhe energji elektrike.

3. Kur vlerësimi i përmendur në pikën 1 të këtij neni dhe analiza e përmendur në pikën 2 të këtij neni identifikojnë një mundësi për aplikimin e kogjenerimit me efiçencë të lartë dhe/ose njësi qendrore të ngrohjes dhe ftohjes, përfitimet e të cilave tejkalojnë kostot, ministria bashkëpunon ngushtësisht me autoritetet bashkiake për vënien në zbatim të masave të përshtatshme për mbështetjen dhe zhvillimin e infrastrukturës efiçente të njësive qendrore të ngrohjes ose ftohjes, ose kogjenerimin me efiçencë të lartë, përfituar nga çlirimi i nxehtësisë dhe burimet e rinovueshme të energjisë.

Neni 14

Në nenin 16, pika 4, shkronja "b" shfuqizohet.

Neni 15

Në nenin 17 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Auditimi energjetik, në kuptim të këtij ligji, kryhet nga auditues energjetikë të pavarur, të cilët certifikohen nga agjencia përgjegjëse për efiçencën e energjisë dhe regjistrohen në regjistrin e saj elektronik. Procedura e certifikimit të audituesit energjetik miratohet nëpërmjet një vendimi të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit, për secilën nga kategoritë e mëposhtme të audituesve energjetikë:

a) auditues energjetikë që kryejnë auditime energjetike në të gjitha kategoritë e ndërtesave rezidenciale, ndërtesa publike të pushtetit lokal e qendror dhe ndërtesa tregtare;

b) auditues energjetikë që kryejnë auditime energjetike në të gjitha objektet industriale, duke përfshirë këtu centralet e transformimit të energjisë;

c) auditues energjetikë që kryejnë auditime energjetike në të gjitha mjetet e sektorit të transportit.

Agjencia përgjegjëse për efiçencën e energjisë mban në çdo kohë regjistrin e përditësuar të audituesve të energjisë, të certifikuar në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave të përcaktuar në këtë pikë, si dhe publikon e përditëson këtë listë në faqen e saj zyrtare të internetit.

Rezultatet e auditimeve energjetike mund të transferohen te një ofrues i shërbimeve energjetike, që konsumatori zgjedh bazuar në kushtin që konsumatori të mos ketë vërejtje në lidhje me këtë.".

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Vendimi i Këshillit të Ministrave, sipas përcaktimit në përmbajtje të pikës 1 të këtij neni, rregullon:

a) kategoritë dhe kërkesat minimale të kualifikimit të audituesve energjetikë së bashku me autorizimin e tyre për të kryer auditime në objekte të ndryshme;

b) përcaktimin e kritereve për përzgjedhjen e institucioneve të miratuara të edukimit dhe/ose trajnimit, të cilat janë të autorizuara nga agjencia përgjegjëse për efiçencën e energjisë, të kryejnë trajnime, duke përfshirë kualifikimet minimale, kapacitetet dhe objektet që këto institucione duhet të zotërojnë;

c) një listë të trajnimeve të detyrueshme profesionale që duhet të përfshijnë të paktën trajnimin për legjislacionin përkatës kombëtar, standardet evropiane dhe ndërkombëtare në fushën e auditimit energjetik dhe menaxhimit energjetik, trajnime teknike për teknikat e auditimit energjetik, teknikat e analizës së kostove, teknikat e shkrimit të një raporti auditimi;

ç) parashikimin e kryerjes së testimeve përfundimtare, vlerësimin e rezultateve dhe certifikimin e atyre që kanë përfunduar me sukses programet e trajnimit;

d) rregulla procedurale për lëshimin e certifikatave audituesve energjetikë të certifikuar më parë nga institucione trajnuese;

dh) rregulla procedurale për njohje të audituesve të certifikuar energjetikë të huaj;

e) kodin e sjelljes së audituesve energjetikë;

ë) raportimet e detyrueshme në agjencinë përgjegjëse për efiçencën e energjisë;

f) metodat e procedurat për të krijuar dhe mirëmbajtur regjistrin elektronik të auditimeve energjetike dhe të audituesve energjetikë;

g) metodat e procedurat për kontrollin e cilësisë së auditimeve energjetike dhe audituesve energjetikë, bazuar në kontrollin të paktën të një përqindjeje të konsiderueshme statistikore të raporteve të auditimit energjetik që ata realizojnë;

gj) vendosjen e kritereve minimale transparente dhe jodiskriminuese për të garantuar cilësinë e lartë të auditimeve energjetike dhe sistemeve të manaxhimit energjetik;

h) arsyet e procedurat për revokimin e përhershëm dhe heqjen nga regjistri të audituesve, për shkak të performancës së dobët e shkeljes së kodit të sjelljes.”.

Neni 16

Neni 18 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 18
Shërbimet energjetike

1. Shërbimet energjetike ofrohen nga shoqëri të specializuara për shërbimet energjetike (ESCO), të cilat duhet të jenë të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Drejtuesit teknikë të shoqërive që ofrojnë shërbimet energjetike janë audituesit energjetikë të certifikuar. Agjencia përgjegjëse për efiçencën e energjisë publikon e përditëson në faqen e saj zyrtare të internetit një listë të ofruesve të disponueshëm të shërbimeve energjetike.

2. Shërbimet energjetike ofrohen mbi bazën e kontraktimit të performancës energjetike sipas një modeli kontrate, i cili do të miratohet përmes një udhëzimi të ministrit, me propozimin e agjencisë përgjegjëse për efiçencën e energjisë.

3. Agjencia përgjegjëse për efiçencën e energjisë publikon në faqen e saj të internetit:

a) praktikat më të mira për kontraktimin e performancës së energjisë, udhëzimet, kontratat model, përfshirë dispozitat që duhet të përfshihen në kontrata të tilla, për të garantuar kursimet e energjisë dhe të drejtat e konsumatorëve fundorë;

b) listën e përditësuar të ofruesve të kualifikuar/certifikuar të shërbimeve energjetike shoqëruar me dokumentacionin përkatës për kualifikimet/certifikatat e tyre, ose sigurimin e një ndërfaqeje ku ofruesit e shërbimeve energjetike mund të ofrojnë këtë informacion;

c) informacion për çdo instrument financiar në dispozicion, masa stimuluese, grante dhe kredi për të mbështetur projektet e shërbimeve të efiçencës së energjisë;

“ç) pikat përkatëse të kontaktit, ku klientët fundorë mund të marrin informacionin e nevojshëm.”.

Neni 17

Pas nenit 18 shtohet neni 18/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 18/1
Efiçenca e energjisë në transformim, transmetim dhe shpërndarje

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe shitësit e energjisë me pakicë janë të detyruar të tërhiqen nga çdo aktivitet (si pengesa në vendosjen e matësve të bilancit, në instalimin e pajisjeve për prodhimin e energjisë për vetëkonsum ose ndërhyrjen në linja për reduktimin e humbjeve dhe auditimin energjetik të këtyre operatorëve etj.,) që mund të pengojë kërkesën dhe ofrimin e shërbimeve energjetike ose masa të tjera të përmirësimit të

efiçencës së energjisë, ose të pengojë zhvillimin e tregjeve për shërbime ose masa të tilla.

2. Enti Rregullator i Energjisë siguron heqjen e atyre masave stimuluese në tarifat e transmetimit dhe të shpërndarjes, që në mënyrë të panevojshme rrisin volumin e energjisë së transmetuar ose të shpërndarë, duke dëmtuar efiçencën e përgjithshme (përfshirë efiçencën e energjisë) të prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë elektrike ose ato që mund të pengojnë pjesëmarrjen e kërkesë-ofertës në balancimin e tregjeve dhe sigurimin e shërbimeve ndihmëse.

3. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes kryejnë auditime energjetike vjetore të humbjeve teknike në operatorin e sistemit të rrjetit dhe zbatojnë masat e nevojshme të efiçencës së energjisë. Këto masa merren parasysh në planin e investimeve të operatorit të sistemit të transmetimit dhe të shpërndarjes në përputhje me ligjin nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

4. Operatorët e sistemit të transmetimit dhe të shpërndarjes, në përputhje me dispozitat e legjislacionit për sektorin e energjisë elektrike, ndërmarrin masat e nevojshme për vendosjen e matësve inteligjentë, duke marrë parasysh kostot dhe përfitimet afatgjata për tregun.".

Neni 18

Nenet 19, 20, 21, 22, 23 e 24 shfuqizohen.

Neni 19

Në nenin 25, pika 3, shkronjat "e", "f", "g" shfuqizohen.

Neni 20

Në nenin 26, pika 1, shkronja "d" shfuqizohet.

Neni 21

Në nenin 28, pas pikës 2 shtohen pikat 3 dhe 4 me këtë përmbajtje:

"3. Gjashtë muaj pas botimit të këtij ligji në Fletoren Zyrtare, konsumatorët e mëdhenj të energjisë deklarojnë tek agjencia përgjegjëse për efiçencën e energjisë konsumin e tyre të energjisë për vitin paraardhës sipas formatit të miratuar me udhëzim të ministrit përgjegjës për energjinë dhe të dhënat e personit të punësuar si menaxher energjie.

4. Konsumatorët e mëdhenj të energjisë, që kanë ngritur sistemin e menaxhimit të energjisë, duhet të dërgojnë certifikatën ISO 500001 brenda 6 muajsh nga publikimi i këtij ligji në Fletoren Zyrtare.".

Neni 22

Kudo në ligj, emërtesa "Agjencia për Efiçencën e Energjisë" zëvendësohet me fjalët "agjencia përgjegjëse për efiçencën e energjisë".

Neni 23
Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve: 8, pika 6; 9, pika 1; 9/4, pika 2; 11/1, pikat 1 dhe 2, dhe 17, pika 1, të ligjit.

2. Ngarkohet ministri që brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve: 9/1, pika 3; 9/4, pika 3; 11, pika 6; 11/1, pika 3; 15/1, pika 1; 18, pika 2, dhe 28, pika 3, të ligjit.

Neni 24
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 8.3.2021.

AKT NORMATIV
Nr. 13, datë 31.3.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 8668, DATË 23.10.2000, "PËR PAJISJEN E SHTETASVE SHQIPTARË ME PASAPORTË PËR JASHTË SHTETIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Neni 14/3, i ligjit nr. 8668, datë 23.10.2000, "Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit", të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Neni 14/3
Dispozitë kalimtare

Afati i vlefshmërisë së pasaportave të shtetasve shqiptarë, që përfundon deri në datën 25 prill 2021, zgjatet deri në datën 30 prill 2021.".

Neni 2
Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

URDHËR
Nr. 183, datë 26.3.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 633, DATË 17.11.2020, "PËR NDALIMIN E GRUMBULLIMEVE NË VENDE TË MBYLLURA APO TË HAPURA"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 7, pika 4, të ligjit nr. 15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive"; të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga *COVID-19*, si edhe të vendimit të Komitetit Teknik nr. 1594, datë 26.3.2021,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 633, datë 17.11.2020, "Për ndalimin e grumbullimeve në vende të mbyllura apo të hapura", bëhet ndryshimi si vijon:

1. Në pikën 1 të urdhrit, togfjalëshi "deri në datën 25.3.2021" zëvendësohet me togfjalëshin "deri në datën 8.4.2021".

2. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR
Nr. 144, datë 30.3.2021

PËR NDALIMIN E PESHKIMIT NË LIQENIN E SHKODRËS

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të pikës 1, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e peshkimit, me çfarëdo lloj mjeti dhe metode gjuetie, si dhe mbajtjen në bord, tranzitimin në barkë, zbarkimin e qëllimtë dhe hedhjen në treg ose për konsum i të gjitha llojeve të peshqve në liqenin e Shkodrës, nga data 1.4.2021 deri më 30.6.2021, me përjashtim të ngjalës, e cila lejohet të peshkohet vetëm me grepa dhe vetëm për periudhën 1.4.2021 deri 30.4.2021, siç është parashikuar në Planin e Menaxhimit të Ngjalës.

2. Për periudhën 1.5.2021–30.6.2021, ndalimin e peshkimit me rrjeta në fashën bregliqenore prej 300 ml nga bregu.

3. Vendbazimi i varkave të peshkimit do të jenë vendet e përcaktuara nga Organizata e Menaxhimit të Peshkimit (OMP), "Liqeni i Shkodrës".

4. Për periudhën njëmujore të lejimit të peshkimit të ngjalës, nga ana e Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit Shkodër, të ketë monitorim të sasive ditore të peshkuara. Sasia e ngjalës së zënë grumbullohet dhe tregtohet te Qendra e Parë e Ankandit Shirokë.

5. Peshku (speciet e familjes Krap) i bllokuar nga Roja e Peshkimit (OMP-Liqeni Shkodër) dhe nga kontrollet e përbashkëta të Rojes së Peshkimit (OMP-Liqeni Shkodër), Inspektoratit të Peshkimit, Policisë Kufitare apo strukturave të tjera që ngarkon ky urdhër, grumbullohet dhe ruhet në Qendrën e Ankandit të Parë Shirokë.

6. Për zbatimin e këtij urdhri të hartohet një Plan i Përbashkët Operativ Veprimi nga Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës në koordinim me OMP-në e këtij liqeni.

7. OMP-Liqeni i Shkodrës të marrë të gjitha masat e zhvendosjes së objekteve ku peshqit (gjuhcë) kanë lëshuar vezët, në rastet e rënies së nivelit të ujit në liqenin e Shkodrës.

8. Ngarkohet Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës në varësi të së cilës është Sektori i Kontrollit të Peshkimit, Organizata e Menaxhimit të Peshkimit të Liqenit të Shkodrës, që të monitorojnë zbatimin e Planit Operativ të Veprimit për zbatimin e këtij urdhri, duke bashkëpunuar me strukturat e qeverisjes vendore, Drejtorinë e Policisë së Rendit dhe atë Kufitare në qarkun e Shkodrës.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Milva Ekonomi

VENDIM
Nr. 10, datë 4.3.2021

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare e Gjykatës Kushtetuese		
Elsa Toska	anëtare e	“	“
Fiona Papajorgji	anëtare e	“	“
Altin Binaj	anëtar i	“	“
Përparim Kalo	anëtar i	“	“
Sonila Bejtja	anëtare e	“	“
Marsida Xhaferllari	anëtare e	“	“

me sekretare Enina Kotoni, në datën 4.3.2021, mori në shqyrtim në seancë plenare publike çështjen me nr. 2 (S)/2019 regj. them., që u përket:

KËRKUESE: Shoqëria “Top-Alb Konfeksion” sh.p.k.

SUBJEKT I INTERESUAR: Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 80-2016-6107, datë 19.12.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe nr. 3748, datë 23.10.2018, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenet 49, 50, 70, 71, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar *(ligji 8577/2000).*

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, përfaqësuesin e kërkueses, i cili kërkoi pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e parashtrimeve dhe mosparaqitjen në seancë të subjektit të interesuar, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja "Top-Alb Konfeksion" sh.p.k. është shoqëri tregtare me seli në Tiranë, me objekt të veprimtarisë së saj linjë konfeksioni me regjim përpunimi aktiv, tregtim me shumicë dhe pakicë.

2. Në datën 5.11.2015 ajo u kontrollua nga inspektorët e subjektit të interesuar, Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, për deklarimin e punonjësve në organin tatimor. Kontrolli u dokumentua me akt konstatim, i cili iu dërgua për veprime të mëtejshme subjektit të interesuar.

3. Gjatë kësaj periudhe, Gjykata Kushtetuese kishte filluar shqyrtimin e kërkesës së një shoqate, me objekt shqyrtimin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të neneve 5, 7, 11, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19 dhe 20 të ligjit nr. 99/2015, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, 'Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë', të ndryshuar" (ligji nr. 99/2015), i cili ka hyrë në fuqi në datën 12.11.2015. Gjatë shqyrtimit kushtetues, Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, në datën 23.12.2015, vendosi pezullimin e zbatimit të ligjit nr. 99/2015 deri në dhënien e vendimit përfundimtar prej saj. Ministria e Financave, si subjekt i interesuar në atë gjykim kushtetues, u njoftua me shkrim në datën 24.12.2015 për pezullimin e zbatimit të ligjit.

4. Pezullimi i zbatimit të ligjit nr. 99/2015 zgjati deri në datën 17.6.2016, kur hyri në fuqi vendimi përfundimtar nr. 33, datë 8.6.2016, i Gjykatës Kushtetuese, pas botimit në Fletoren Zyrtare nr. 108, datë 16.6.2016. Me këtë vendim u shfuqizuan si të papajtueshme me Kushtetutën nenet 5, 14, 15, 16 (pika 4 e shtuar në nenin 121), 17, pikat 1 dhe 2, 18 (pika 2 e nenit 124) dhe 20 të ligjit nr. 99/2015.

5. Ndërkohë që ligji ishte i pezulluar, subjekti i interesuar i ka dërguar kërkueses aktin nr. 82316/16, datë 6.1.2016, "Njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore", me të cilin e njoftonte se për shkak të punonjësve të padeklaruar ajo kishte detyrime për sigurimet shoqërore në masën 6138 lekë për muajin nëntor 2015, si dhe i ishin caktuar dy gjoba gjithsej në shumën 512.276 lekë. Në aktin e njoftimit janë shënuar si bazë ligjore nenet 116, pika 1 dhe 119 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar (ligji nr. 9920/2008). Neni 119 i këtij ligji ishte ndryshuar në përmbajtjen e tij për masën e gjobës nga neni 14 i ligjit nr. 99/2015, i cili ishte pezulluar në tërësi nga Gjykata Kushtetuese.

6. Kërkuesja nuk ka paraqitur ankim administrativ kundër njoftimit të vlerësimit tatimor brenda 30 ditëve, siç parashikon neni 69 i ligjit nr. 9920/2008. Për rrjedhojë, subjekti i interesuar ka filluar procedurat e mbledhjes së detyrimeve tatimore, duke njoftuar me shkrim kërkuesen për ekzekutimin vullnetar në datën 6.10.2016, duke vendosur barrën hipotekore e siguruese në datën 20.10.2016 dhe duke njoftuar kërkuesen për bllokimin e llogarive bankare për shumën e detyrimit në datën 20.10.2016.

7. Në këto rrethana, kërkuesja, me pretendimin se njoftimi i vlerësimit tatimor ishte nxjerrë nga subjekti i interesuar në kapërcim të kompetencave ligjore për shkak të pezullimit të ligjit nr. 99/2015, i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi, duke kërkuar pavlefshmërinë absolute të njoftimit të vlerësimit tatimor, si dhe detyrimin e subjektit të interesuar për heqjen e barrëve siguruese dhe për kthimin e garancisë.

8. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 80-2016-6107, datë 19.12.2016, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, me arsyetimin se pretendimi i kërkueses është i pabazuar pasi kompetenca e administratës tatimore për të ushtruar kontroll tatimor bazohet në ligjin nr. 9920/2008, përtej ndryshimeve që ai ka pësuar me ligjin nr. 99/2015, të pezulluar.

9. Në vijim, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 3748, datë 23.10.2018, ka vendosur lënien në fuqi të këtij vendimi, duke arsyetuar, ndër të tjera, se akti i konstatimit është mbajtur në datën 5.11.2015, përpara se Gjykata Kushtetuese të pezullonte ligjin nr. 99/2015. Në dispozitivin e vendimit është shënuar se kundër këtij vendimi nuk lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë.

10. Në datën 25.2.2019, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë. Kolegji i Gjykatës Kushtetuese në datën 12.2.2020 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

11. Kërkuesja në kërkesën e saj ka parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, se vendimet gjyqësore të kundërshtuara prej saj kanë cenuar:

11.1 *Parimin e sigurisë juridike,* pasi gjykatat në dhënien e vendimeve nuk kanë analizuar nëse ka pasur ligj të qartë për zgjidhjen e çështjes dhe nuk kanë zbatuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese për pezullimin e ligjit nr. 99/2015, që përbënte bazën ligjore të njoftimit të vlerësimit tatimor.

11.2 *Standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor,* si pjesë e procesit të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, pasi gjykatat nuk kanë arsyetuar për pretendimin për zbatueshmërinë e ligjit të pezulluar nga Gjykata Kushtetuese, si dhe nëse subjekti i interesuar, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, në datën 6.1.2016, kishte kompetencë të vendoste detyrime dhe sanksione për kërkuesen.

11.3 *Të drejtën e pronës,* e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi të ardhurat monetare përbëjnë pronë dhe, rrjedhimisht, e drejta e pronës së kërkueses është kufizuar me akt administrativ bazuar në një ligj të pezulluar, duke shkelur kështu nenin 17, pika 1, të Kushtetutës, që lejon kufizimin e pronës vetëm me ligj.

12. Subjekti i interesuar, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, ndonëse u njoftua rregullisht, nuk paraqiti shpjegime me shkrim dhe as nuk u paraqit në seancë.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

13. Gjykata Kushtetuese vë në dukje se prej datës 23.3.2018 nuk ka pasur kuorumin e nevojshëm ligjor të parashikuar nga neni 32, pika 1, i ligjit nr. 8577/2000, për shqyrtimin çështjeve në seancë plenare. Pas plotësimit të këtij kuorumi u bë e mundur marrja në shqyrtim e çështjes konkrete.

A. Për legjitimimin e kërkueses

14. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhen me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", 134 pika 1, shkronja "i" dhe 134, pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

15. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

16. Gjykata vlerëson se kërkuesja shoqëria "Top-Alb Konfeksion", si person juridik është subjekt i së drejtës private dhe bartëse e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë, dhe legjitimohet *ratione personae,* në përputhje me nenet 131, pika 1, shkronja "f", 134, pika 1, shkronja "i" dhe 134, pika 2, të Kushtetutës, sepse ka qenë palë në procesin gjyqësor në gjykatat administrative, vendimet gjyqësore të të cilave ajo kundërshton.

17. Për sa i takon *shterimit të mjeteve juridike,* Gjykata, në praktikën e saj, ka pranuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, shterimi i mjeteve juridike nënkupton që ankuesi duhet të shfrytëzojë në shkallët e sistemit gjyqësor të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara të shkelura. Mjetet ligjore shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimin nr. 56, datë 25.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Në çështjen konkrete vendimi i fundit është dhënë nga Gjykata Administrative e Apelit, i cili bazuar në nenin 56 të ligjit nr. 49/2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar *(ligji nr. 49/2012)* është i paankimueshëm në Gjykatën e Lartë, për pasojë ky vendim gjyqësor ka vendosur në mënyrë përfundimtare për pretendimet e kërkueses. Në këto rrethana, Gjykata çmon se kërkuesja e ka plotësuar kriterin e shterimit të mjeteve juridike, pasi nuk ka mjet tjetër ligjor për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese.

18. Po ashtu, Gjykata vlerëson se kërkuesja legjitimohet edhe *ratione temporis,* pasi e ka paraqitur kërkesën e saj brenda afatit 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit nr.

8577/2000. Vendimi i fundit gjyqësor i kundërshtuar prej saj është dhënë nga Gjykata Administrative e Apelit në datën 23.10.2018, ndërsa kërkesa është dërguar nëpërmjet shërbimit postar në datën 25.2.2019, ditë e hënë, që përkon me ditën e fundit të afatit 4-mujor, sipas pikës 2 të nenit 1 të ligjit nr. 49/2012 dhe nenit 148 të Kodit të Procedurës Civile.

19. Në drejtim të legjitimimit *ratione materiae,* kërkuesja ka pretenduar se nga vendimet gjyqësore të kundërshtuara asaj i janë cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor në aspektin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, parimi i sigurisë juridike dhe e drejta e pronës. Në thelb, kërkuesja, siç saktësoi edhe në seancë gjyqësore, kundërshton caktimin e gjobës nga administrata tatimore, me pretendimin se caktimi i gjobës i ka shkaktuar kufizim të së drejtës së pronës, me një akt administrativ bazuar në një ligj të paqartë dhe të pezulluar nga Gjykata Kushtetuese, duke shkelur në këtë mënyrë nenin 17, pika 1, të Kushtetutës. Kërkuesja, në funksion të kundërshtimit të caktimit të gjobës, parashtron edhe argumentet për sigurinë juridike dhe arsyetimin e vendimit gjyqësor.

20. Pavarësisht se kërkuesja e ka paraqitur pretendimin për cenimin e së drejtës së pronës sipas nenit 17, pika 1, të Kushtetutës, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se argumentet lidhen me procesin ligjor administrativ dhe gjyqësor të zhvilluar ndaj kërkueses, bazuar në parimin *iura novit curia*, çmon ta analizojë çështjen e paraqitur në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë. Në vlerësimin e së drejtës së pronës së kërkueses, Gjykata evidenton se detyrimet tatimore, duke përfshirë edhe gjobën, janë pjesë e konceptit kushtetues të pronës, pasi pagesa e një sasie të caktuar të hollash, e barasvlershme me masën e detyrimit tatimor, gjobave dhe interesave është një shumë e cila merret nga pasuria e tatimpaguesit, si pasojë e detyrimit, që vetë tatimpaguesit i buron nga ligji, për të paguar detyrimet financiare *(shih vendimin nr. 16, datë 25.7.2008, të Gjykatës Kushtetuese).*

21. Për sa më lart, për të përcaktuar nëse kërkueses i është cenuar e drejta e pronës, është e rëndësishme të analizohet në themel nëse procesi ligjor i zhvilluar nga gjykatat administrative, të cilat kanë dhënë vendimet që kundërshtohen nga kërkuesja, ka përmbushur standardet e procesit të rregullt në këndvështrim të parimit të sigurisë juridike dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

B. *Për themelin e pretendimeve*

B.1. Për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike

22. Kërkuesja ka pretenduar se Drejtoria Tatimore Rajonale Tiranë ka marrë vendim për detyrimet tatimore të saj bazuar në një ligj të pezulluar nga Gjykata Kushtetuese, duke cenuar për pasojë sigurinë juridike, pasi ligji nuk ka qenë i qartë. Sipas kërkueses, megjithëse ajo e ka ngritur këtë pretendim para gjykatave administrative, këto gjykata nuk e kanë pranuar pretendimin e saj dhe për këtë shkak, sipas saj, siguria juridike ka vijuar të cenohet. Po ashtu, sipas kërkueses, siguria juridike është cenuar edhe për shkak të mosrespektimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese për pezullimin e ligjit nr. 99/2015. Në seancë gjyqësore, kërkuesja saktësoi se këto pretendime të saj lidhen vetëm me gjobën e caktuar nga administrata tatimore, për të cilën është përdorur si bazë ligjore neni 119 i ligjit nr. 9920/2008, me ndryshimin që kishte pësuar nga neni 14 i ligjit nr. 99/2015.

23. Nenet 124 dhe 132 të Kushtetutës shprehen qartësisht në lidhje me forcën detyruese që vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë mbi të gjitha organet kushtetuese, autoritetet publike, duke përfshirë edhe gjykatat. Zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është detyrim kushtetues. Ato kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Si të tilla, përbëjnë jurisprudencë kushtetuese, e për rrjedhojë, kanë efektet e forcës së ligjit. Ky efekt detyrues ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit. Efekti detyrues shtrihet tek argumentet thelbësore të vendimit, që përbëjnë edhe *ratio decidendi,* eliminimi i të cilave do ta bënte vendimin, në tërësinë e tij, të pakuptimtë *(shih vendimet nr. 49, datë 3.7.2017; nr. 15, datë 1.3.2017; nr. 44, datë 29.6.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Nga ana tjetër, siguria juridike është ndër elementet thelbësore të shtetit të së drejtës, që sanksionohet në nenin 4 të Kushtetutës, si një prej parimeve themelore të organizimit shtetëror. Jurisprudenca kushtetuese ka pohuar se siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit te shteti, institucionet e

tij dhe tek aktet që ato nxjerrin *(shih vendimet nr.11, datë 16.4.2018; nr.81, datë 18.12.2017, të Gjykatës Kushtetuese)*. Gjykata, edhe gjatë shqyrtimit të ankesave individuale kushtetuese, e ka analizuar sigurinë juridike, të lidhur me pretendimet për mosrespektimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, duke theksuar se parimi i shtetit të së drejtës ku mbështetet një shtet demokratik, nënkupton sundimin e ligjit dhe mënjanimin e arbitraritetit, me qëllim që të arrihet respektimi dhe garantimi i dinjitetit njerëzor, drejtësisë dhe sigurisë juridike. Parimi i sigurisë juridike përfshin, krahas qartësisë, kuptueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit normativ, edhe besimin e individëve te sistemi juridik *(shih vendimin nr. 17, datë 10.4.2015, të Gjykatës Kushtetuese)*.

25. Po ashtu, Gjykata ka pranuar se parimi themelor i shtetit të së drejtës lidhet edhe me të drejtën e procesit të rregullt ligjor, pasi kjo e fundit, ndër të tjera, ka për qëllim të garantojë shtetasit nga çdo veprim që u shkakton cenim të të drejtave të tyre, pa përjashtuar rastet kur cenimi vjen nga një akt i administratës shtetërore. Shteti i së drejtës presupozon se çdo ndërhyrje e autoriteteve ekzekutive në të drejtat e individit ose të personave juridikë duhet të jetë objekt i një kontrolli efektiv nga një organ që ofron garantimin e pavarësisë dhe paanësisë gjatë këtij procesi *(shih vendimet nr. 25, datë 28.4.2014; nr. 10, datë 4.4.2007, të Gjykatës Kushtetuese)*.

26. Duke iu kthyer çështjes në gjykim, Gjykata konstaton se njoftimi i vlerësimit, i cili krahas detyrimeve tatimore, caktonte edhe gjoba ndaj kërkueses, është nxjerrë nga subjekti i interesuar, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, në datën 6.1.2016 dhe është i bazuar në nenin 119 të ligjit nr. 9920/2008, të ndryshuar me nenin 14 të ligjit nr. 99/2015, zbatimi i të cilit ishte pezulluar më parë nga Gjykata Kushtetuese me vendimin e datës 23.12.2015. Si rrjedhim, subjekti i interesuar, në ushtrimin e kompetencës për njoftimin e vlerësimit tatimor, në cilësinë e një organi shtetëror, ka cenuar parimin e ligjshmërisë në drejtim të zbatimit të një ligji të pezulluar dhe parimin e sigurisë juridike, në drejtim të respektimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese për pezullimin e ligjit. Për më tepër, edhe gjykatat administrative që kanë shqyrtuar dhe kanë dhënë vendim për padinë e kërkueses, duke e rrëzuar atë, nuk janë shprehur për këtë rrethanë.

27. Në këtë mënyrë, gjykatat administrative nuk e kanë përmbushur detyrimin kushtetues për zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese për pezullimin e ligjit, vendim i cili ka fuqi detyruese të përgjithshme dhe forcën e ligjit për të gjitha organet publike, duke përfshirë edhe gjykatat. Duke marrë shkas nga çështja në shqyrtim, Gjykata thekson se efekti detyrues dhe *erga omnes* i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese ka të bëjë edhe me vendimet për pezullimin e zbatimit të ligjit ose të akteve normative. Gjykata Kushtetuese kur vendos një pezullim të tillë, ka vlerësuar pasojat që vijnë nga zbatimi i mëtejshëm i tij ndaj interesave shtetërore, shoqërore ose të individëve. Ky lloj vendimi nënkupton ndërprerjen në mënyrë të menjëhershme dhe për një kohë të caktuar të efekteve juridike të ligjit ose të aktit normativ të pezulluar, ndërprerje e cila është e detyrueshme për t'u zbatuar jo vetëm nga palët konkrete në gjykimin kushtetues, ku jepet vendimi i pezullimit, por nga të gjitha subjektet e zbatimit të ligjit ose aktit normativ, deri në një vendim përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese.

28. Në analizë të fundit, Gjykata vlerëson se në çështjen konkrete, zbatimi nga administrata tatimore i dispozitave të një ligji të pezulluar nga Gjykata Kushtetuese dhe më pas, mosriparimi i kësaj situate nga gjykatat, në përmbushje të rolit të subsidiaritetit, dëshmon se gjykatat nuk kanë ushtruar kontroll efektiv për ndërhyrjen që administrata tatimore ka bërë tek e drejta e pronës së kërkueses, e për rrjedhojë, kanë cenuar sigurinë juridike. Duke cenuar sigurinë juridike, gjykatat administrative nuk kanë përmbushur detyrimet e tyre për realizimin e një procesi të rregullt ligjor dhe gjykimi të drejtë sipas nenit 42 të Kushtetutës, të lidhur me parimin themelor të shtetit të së drejtës dhe të ligjshmërisë të sanksionuar nga neni 4 i Kushtetutës. Për këtë arsye, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkueses është i bazuar.

B.2. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

29. Kërkuesja ka pretenduar se gjykatat kanë cenuar standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi nuk i kanë dhënë përgjigje kërkimit kryesor të saj, nëse organi tatimor ishte kompetent për të vendosur detyrimet tatimore bazuar në një ligj të pezulluar nga Gjykata Kushtetuese.

30. Në lidhje me standardin e arsyetimit, Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj ka

theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë *(shih vendimin nr. 18, datë 15.3.2016, të Gjykatës Kushtetuese)*. Me arsyetimin, gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm që e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim *(shih vendimin nr. 18, datë 15.3.2016, të Gjykatës Kushtetuese)*.

31. Duke iu kthyer çështjes në gjykim, Gjykata vëren se ligji nr. 9920/2008 përcakton si veprime administrative të ndara në kohë vlerësimin tatimor (neni 68), njoftimin e vlerësimit tatimor (neni 69) dhe kontrollin tatimor (nenet 80–87). Subjekti i interesuar ka ushtruar kontroll në ambientet e veprimtarisë së kërkueses në datën 5.11.2015, përpara dhënies së vendimit të pezullimit të ligjit nga Gjykata Kushtetuese, ndërsa akti i njoftimit të vlerësimeve tatimore drejtuar kërkueses është nxjerrë nga subjekti i interesuar në datën 6.1.2016, datë në të cilën ishte në fuqi vendimi i pezullimit të ligjit prej Gjykatës Kushtetuese. Në vlerësimin e këtyre rrethanave, Gjykata evidenton se subjekti i interesuar, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë jo vetëm nuk ka paraqitur parashtrime me shkrim, por edhe nuk u paraqit në seancë për të shpjeguar datën në të cilën ishte kryer vlerësimi tatimor prej saj në përputhje me nenin 68 të ligjit nr. 9920/2008. Nga ana tjetër, kërkuesja ritheksoi në seancë se ajo nuk është njoftuar për datën e kryerjes së vlerësimit dhe se asaj i është njoftuar vetëm akti i njoftimit të vlerësimit tatimor, i cili mban datën 6.1.2016.

32. Në këto rrethana, Gjykata vëren se për pretendimin e kërkueses mbi nxjerrjen e një akti administrativ bazuar në një ligj të pezulluar nga Gjykata Kushtetuese, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë është përgjigjur se ky pretendim lidhet me pavlefshmërinë relative dhe nuk sjell si pasojë pavlefshmërinë absolute të aktit. Ndërsa Gjykata Administrative e Apelit Tiranë është shprehur se në datën 5.11.2015, kur është mbajtur akt konstatimi nga inspektorët, ligji nr. 99/2015, i cili kishte ndryshuar ligjin nr. 9920/2008, nuk ka qenë ende i pezulluar, e për rrjedhojë, ka rrëzuar kërkimet për pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ. Në këtë mënyrë, në pjesën arsyetuese të vendimit gjyqësor të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, ashtu siç vë në dukje kërkuesja, është përcaktuar se gjoba është nxjerrë në datën 5.11.2015, që përkon me datën e konstatimit të shkeljes përmes inspektimit, kur ende nuk ishte vendosur pezullimi i ligjit nga Gjykata Kushtetuese.

33. Në këtë situatë, gjykatat administrative në vendimet gjyqësore nuk kanë arsyetuar për vlerën detyruese të vendimit të Gjykatës Kushtetuese për pezullimin e ligjit në raport me veprimet konkrete që ka kryer administrata tatimore gjatë asaj periudhe. Kjo mangësi është shkaktuar për shkak të përcaktimit pa arsyetim në këto vendime të datës 5.11.2015, si data e ushtrimit të kontrollit tatimor, që bën të ligjshme veprimet e administratës tatimore, por nuk është identifikuar as baza ligjore dhe nuk është dhënë asnjë shpjegim përse duhet konsideruar pikërisht kjo datë dhe përse është përjashtuar ajo e njoftimit të vlerësimit tatimor të kërkueses që është data 6.1.2016.

34. Për sa më lart, Gjykata çmon se gjykatat administrative nuk kanë përmbushur detyrën e tyre kushtetuese për ushtrimin e pushtetit gjyqësor për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve përmes përcaktimit të fakteve dhe zbatimit të ligjit, që materializohet në arsyetimin e vendimit. Vendimet e dhëna prej tyre përmbajnë fakte pa arsyetim, si dhe nuk kanë respektuar forcën detyruese të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, duke sjellë si pasojë cenimin e së drejtës së pronës së kërkueses. Për rrjedhojë, edhe pretendimi i kërkueses për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është i bazuar.

35. Së fundmi, Gjykata vëren se kërkuesja gjatë seancës përsëriti kërkimin për të shfuqizuar të dyja vendimet e gjykatave administrative dhe dërgimin për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke u shprehur se thelbi i këtij kërkimi synonte të evidentonte faktin se sipas saj procesi në të dyja shkallët ishte zhvilluar në shkelje të standardeve kushtetuese.

36. Për këtë pretendim, Gjykata rithekson se raporti ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe

juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur shqyrtohen ankesa individuale kushtetuese, në bazë të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit). Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj (*shih vendimet nr. 52, datë 2.12.2013; nr. 36, datë 25.7.2013; nr. 58, datë 24.12.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Në vështrim të standardeve të mësipërme, Gjykata çmon se duhet të shfuqizohet vetëm vendimi nr. 3748, datë 23.10.2018 i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, duke e dërguar çështjen për shqyrtim pranë saj. Kjo e fundit, duke u bazuar në kompetencat si gjykatë ligji dhe fakti, është në pozicionin e duhur për të shqyrtuar pretendimet e kërkueses dhe për t'iu dhënë përgjigje atyre në respektim të standardeve kushtetuese, si dhe duke plotësuar mangësitë dhe riparuar gabimet e gjykatës së shkallës së parë.

38. Si përfundim, Gjykata vlerëson se kërkesa e kërkueses "Top-Alb Konfeksion" është e bazuar në themelin e saj për cenimin e së drejtës së pronës nga një proces i parregullt ligjor në drejtim të sigurisë juridike dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, por duhet të pranohet vetëm për shfuqizimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i" të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 3748, datë 23.10.2018, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 4.3.2021.
Shpallur më 29.3.2021.

Kryetare: Vitore Tusha
Anëtarë: Fiona Papajorgji, Elsa Toska, Përparim Kalo, Altin Binaj, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja

MENDIM PARALEL

1. Për arsye se nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën lidhur me analizën e çështjes vetëm në këndvështrim të së drejtës për proces të rregullt ligjor, për shkak të mosrespektimit të së cilës kërkueses i është cenuar e drejta e pronës, e çmoj të rëndësishme të shprehem për sa vijon.

2. Kërkuesja ka pretenduar se në çështjen konkrete ka pasur një shkelje të së drejtës së pronës, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi të ardhurat monetare përbëjnë pronë dhe, rrjedhimisht, e drejta e pronës së kërkueses është kufizuar me akt administrativ bazuar në një ligj të pezulluar, duke shkelur kështu nenin 17, pika 1, të Kushtetutës, që lejon kufizimin e pronës vetëm me ligj *(shih paragrafin 11.3 të vendimit)*. Gjithashtu, në seancën plenare publike të datës 4.3.2021, kërkuesja ka parashtruar se pretendimi lidhur me cenimin e së drejtës së pronës është si i ndërlidhur, ashtu edhe i pavarur nga pretendimi për cenimin e procesit të rregullt ligjor dhe se në këtë aspekt e drejta e pronës cenohet jo vetëm nga procesi i parregullt, por në mënyrë të pavarur edhe nga vetë masa e gjobës, e cila është vendosur në një kohë kur ligji ishte pezulluar nga Gjykata Kushtetuese *(procesverbal i seancës plenare, datë 4.3.2021, faqet 8–11)*.

3. Shumica ka analizuar pretendimet e sipërcituara, duke u shprehur, se: *"për të përcaktuar nëse kërkueses i është cenuar e drejta e pronës, është e rëndësishme të analizohet në themel nëse procesi ligjor i zhvilluar nga gjykatat administrative, të cilat kanë dhënë vendimet që kundërshtohen nga kërkuesja, ka përmbushur standardet e procesit të rregullt në këndvështrim të sigurisë juridike dhe të arsyetimit të vendimit gjyqësor" (paragrafi 21 i vendimit)*. Lidhur me faktin nëse në çështjen konkrete ka shkelje të së drejtës së pronës, Gjykata është shprehur: "*Vendimet e dhëna prej tyre [vendimet e gjykatave më të ulëta] përmbajnë fakte pa arsyetim, si dhe*

nuk kanë respektuar forcën detyruese të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, duke sjellë si pasojë cenimin e së drejtës së pronës së kërkueses" (paragrafi 34 i vendimit). Si përfundim, Gjykata vlerëson se kërkesa e kërkueses "Top-Alb Konfeksion" është e bazuar në themelin e saj për cenimin e së drejtës së pronës nga një proces i parregullt ligjor në drejtim të sigurisë juridike dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor (paragrafi 38 i vendimit)".

4. Për sa më sipër, konstatohet se shumica ka shqyrtuar pretendimin e kërkueses për cenim të së drejtës së pronës vetëm në aspektin e procesit të rregullt procedural dhe ka vendosur se ka shkelje të së drejtës së pronës nga një proces i parregullt ligjor në drejtim të sigurisë juridike dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

5. Nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën, pasi ajo nuk ka marrë në analizë pretendimin për shkeljen e së drejtës së pronës në dimension kushtetues, në aspektin substancial të saj, por i ka dhënë përgjigje vetëm pretendimit të së drejtës së pronës të parë ngushtë me procesin e rregullt ligjor procedural, qëndrim i cili nuk reflekton ndryshimet kushtetuese dhe ligjore të kompetencës së Gjykatës Kushtetuese për të shqyrtuar pretendimet e individëve për cenim të të drejtave themelore të garantuara me Kushtetutë nëpërmjet një akti publik apo vendimi gjyqësor, siç është edhe e drejta e pronës private në rastin konkret. Ndryshe nga shumica, vlerësoj se gjykata duhet kishte shqyrtuar edhe pretendimin e kërkueses veçmas për shkelje të së drejtës së pronës për shkak të vendosjes së masës së gjobës dhe jo vetëm pretendimin për shkeljen e së drejtës së pronës të lidhur me të drejtën për proces të rregullt ligjor. Ajo në mënyrë të pavarur duhet të merrte në shqyrtim edhe pretendimin për shkelje të nenit 41 të Kushtetutës.

6. Në mendimin tim, shumica nuk duhej të shmangte kompetencën e saj për kontroll substancial të së drejtës së pronës dhe ndërhyrjen në këtë të drejtë, sanksionuar në nenin 41 të Kushtetutës dhe nenin 1 të protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Duke mbajtur në konsideratë se argumentet lidhen jo vetëm me procesin gjyqësor të zhvilluar ndaj kërkueses, por edhe me cenimin e së drejtës së pronës në aspektin substancial, çmoj se çështja duhej të ishte analizuar, së pari, në këndvështrim të nenit 41/1 të Kushtetutës, sipas të cilit e drejta e pronës private është e garantuar. Gjykata Kushtetuese mund të vlerësojë mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, që në parim u takon gjykatave të sistemit të zakonshëm, vetëm nëse përmes këtij procesi janë cenuar të drejtat kushtetuese të individit dhe jo vetëm ato të lidhura me procesin e rregullt ligjor procedural, sipas perspektivës së re të normave kushtetuese dhe ligjore për ankimin kushtetues individual.

7. Sipas nenit 131/1/f të Kushtetutës, përmbajtja e të cilit është ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, Gjykata Kushtetuese vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave, përveçse kur parashikohet ndryshe në Kushtetutë.

8. Neni 71 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, parashikon: "*Çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, kur është palë në një proces ligjor ose kur është bartës i të drejtave dhe i lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta ka të drejtë të kundërshtojë para Gjykatës Kushtetuese çdo akt që cenon të drejtat dhe liritë e parashikuara në Kushtetutë, sipas kritereve të parashikuara në nenin 71/a të këtij ligji*".

9. Në shqyrtimin e pretendimit të kërkueses për cenimin e së drejtës së pronës, fillimisht duhej vlerësuar nëse në rastin konkret ka pasur një të drejtë prone, në kuptim të nenit 41/1 të Kushtetutës dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Lidhur me ekzistencën e së drejtës së pronës, edhe shumica, në paragrafin 20 të vendimit, ka evidentuar faktin se detyrimet tatimore, duke përfshirë edhe gjobën, janë pjesë e konceptit kushtetues të pronës, pasi pagesa e një sasie të caktuar të hollash, e barasvlershme me masën e detyrimit tatimor, gjobave dhe interesave është një shumë e cila merret nga pasuria e tatimpaguesit, si pasojë e detyrimit, që vetë tatimpaguesit i buron nga ligji, për të paguar detyrimet financiare *(shih vendimin nr. 16, datë 25.7.2008, të Gjykatës Kushtetuese).* Edhe GJEDNJ-ja në jurisprudencën e saj është shprehur se: *vendosja e një gjobe në parim përbën ndërhyrje në të drejtën e garantuar nga paragrafi i parë i nenit 1 të Protokollit nr. 1, pasi privon personin e interesuar nga një pjesë e pronës, përkatësisht shumën që duhet të paguhet (shih Phillips kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 41087/98, § 50, KEDNJ 2001-VII). Për rrjedhojë, neni 1 i protokollit 1 i Konventës është i aplikueshëm" (Valico S.r.l. k. Itali*

(dec.), *aplikim nr. 70074/01*). Pra, kërkuesja ka pasur një të drejtë prone, në formën e një shume që i duhej paguar shtetit, (gjobë), në kuptim të nenit 41/1 dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

10. Për sa i përket shqyrtimit, nëse ka pasur ndërhyrje në të drejtën e pronës për shkak të vendosjes së gjobës, në nenin 17 të Kushtetutës parashikohet: *"1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. 2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut"*. Pra, sipas nenit 17 të Kushtetutës të drejtat dhe liritë e individit mund të kufizohen vetëm me ligj.

11. Neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së parashikon, se: "*çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare*". Sipas jurisprudencës së konsoliduar të GJEDNJ-së kërkohet që ndërhyrja në të drejtën e kërkuesit për pronë të jetë jo vetëm e bazuar në ligj, por edhe proporcionale. Megjithatë, sipas GJEDNJ-së një konstatim për mosrespektimin e kriterit të ligjshmërisë në shumicën e rasteve është vendimtar për të gjetur se ka një shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Në raste të tilla, GJEDNJ-ja vendos se nuk është e nevojshme që të vlerësojë proporcionalitetin e ndërhyrjes në të drejtën e pronës (*shih, ndër shumë vendime të tjera, Iatridis kundër Greqisë*, § 62, nr. aplikimi 31107/96, vendim i datës 25.3.1999; *Sharxhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, § 174, nr. aplikimi 10613/16, vendim i datës 11.1.2018).

12. Duke iu kthyer çështjes konkrete, me qëllim shqyrtimin e ndërhyrjes në të drejtën e pronës, duhet të vlerësohet nëse masa e gjobës ishte e ligjshme ose jo. Masa e gjobës në rastin konkret është vendosur me aktin nr. 82316/16, "Njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore" të datës *6.1.2016*, në një kohë kur Gjykata Kushtetuese në datën *23.12.2015* kishte pezulluar zbatimin e ligjit nr. 99/2015, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 'Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë', të ndryshuar", mbi bazën e të cilit ishte vendosur masa e gjobës ndaj kërkueses. Për rrjedhojë, vlerësoj se ndërhyrja në të drejtën e pronës është e paligjshme, pasi subjekti i interesuar në ushtrimin e kompetencës për njoftimin e vlerësimit tatimor dhe vendosjen e gjobës ka cenuar parimin e ligjshmërisë, në drejtim të zbatimit të një ligji të pezulluar nga Gjykata Kushtetuese dhe parimin e sigurisë juridike, në drejtim të mosrespektimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese për pezullimin e ligjit. Për këtë arsye, sa kohë që vendosja e gjobës ka qenë e paligjshme për shkak të zbatimit të një ligji të pezulluar, vlerësoj se dhe ndërhyrja në të drejtën e pronës ka qenë e paligjshme.

13. Në përfundim, vlerësoj se në këtë çështje duhej të arrihej në konkluzionin se ka pasur shkelje të nenit 41/1 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, veçmas, duke e shqyrtuar të drejtën e pronës në aspektin substancial, si një e drejtë themelore, si dhe shkelje të nenit 41/1, së drejtës së pronës, të lidhur me nenin 42 të Kushtetutës, si rezultat i cenimit të parimit të sigurisë juridike dhe të mosarsyetimit të vendimit gjyqësor.

Shpallur më 29.3.2021.

Anëtare: Elsa Toska

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2021 - Numri: 52
Datë: 2021/04/01 16:00:00
f16545a2-5a9c-43b3-817a-923a3567a4ee

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 96 lekë